

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Deme Gjulja

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar me nr. 16/2 prot., datë 13.05.2024, ju sqarojmë se:

Bazuar në të dhënat tuaja dhe informacionin e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër, rezulton se jeni e datëlindjes 01.12.1962 dhe sipas nenit 92, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, *mosha në vite që duhet për gruan në vitin 2024 është 61 vite e 8 muaj dhe vjetërsia e plotë 38 vite e 4 muaj*, moshën për pension pleqërie e plotësoni në datën 01.08.2024.

E drejta për të përfituar pension pleqërie ju lind në rast se plotësoni kushtet sipas nenit 31, të Ligjit të sipërcituar, në të cilin përcaktohet se: *personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92.*

Më datë 31.01.2024, keni aplikuar nëpërmjet portalit e-Albania, tek shërbimi: Vërtetim për periudha pune në ish - kooperativat bujqësore (KB), adresuar DRSSH Dibër, por ky aplikim është refuzuar më datë 01.02.2024, me arsyetimin se nuk keni deklaruar asnjë të dhënë. *(Në këtë aplikim duhet të deklarohet emri i kooperativës bujqësore, sektori, brigada, profesioni i ushtruar dhe periudha e punës).*

Në këto kushte, për t'u pajisur me vërtetimin që kërkon, duhet të riaplikoni sërish nëpërmjet portalit e-Albania, tek i njëjti shërbim, dhe të bëni deklaram të saktë për kooperativën bujqësore (në këtë rast koop. bujq. e Luznisë), sektorin, brigadën, profesionin e ushtruar dhe periudhën e punës.

Për sa shkruani, *se dokumentat e kësaj kooperative bujqësore janë djegur*, ju sqarojmë se, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15.07.2020 "Për miratimin e listës së ish- kooperativave bujqësore, për të cilat nuk disponohet dokumentacion i vjetërsisë në punë", kjo kooperativë bujqësore nuk përshihet në listën e kooperativave të djegura apo nuk disponohet dokumentacion i vjetërsisë në punë, të përcaktuara në këtë VKM,

Ndërsa në lidhje me pyetjen tuaj, për derdhje kontributesh si e vetëpunësuar në bujqësi, për plotësimin e periudhave kontributive, për efekt përfitimi të pensionit të pleqërisë, sqarojmë se, bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015, "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet

nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar, për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësoni kushtet e mëposhtme:

- Të banoni në të njëjtin rreth ku keni tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvilloni veprimtari bujqësore e blegtorale;
- Të banoni në fshat, megjithëse tokën mund ta keni në rrethin fqinjë.

Sa më sipër, nëse keni tokë bujqësore në pronësi ose përdorim, ushtroni veprimtari bujqësore/blektorale dhe banoni në të njëjtin rreth ku keni tokën, mund të siguroheni si e vetëpunësuar në bujqësi, për përfitimin e pensionit të pleqërisë, deri në momentin që mbushni moshën për pension pleqërie, përkatësisht, 61 vjeç e 8 muaj.

Për të realizuar procedurën e sigurimit si e vetëpunësuar në bujqësi duhet të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër dhe të kontaktoni me inspektorin e të vetëpunësuarve në bujqësi, pranë kësaj Drejtorie.

Faleminderit për mirëkuptimin.